



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të cilat i parashtrohen Kryetarit të Komunës për mbështetje financiare për renovimin apo ndërtimin e shtëpive për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike.

Komisioni formohet në përbërje si vijon:

- 1.Ymer Bikliqi, Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim, kryesues
- 2.Agim Krasniqi, Drejtorati për Shëndetësi dhe përkujdesje sociale, anëtar
- 3.Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është të bëjë konstatimin e gjendjes faktike në teren me procesverbal dhe foto të bashkëngjitura dhe të nxjerr Rekomandim për Kryetarin e Komunës përkitazi me kërkesat e parashtruara.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Kryetarit të Komunës për formimin e Komisionit 1Nr. 400-10147 i datës 07.03.2017

1Nr. 400-39841

Lipjan, më 29.06.2018

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

